

UDHËZIM
Nr.11, datë 18.12.2009

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 24.07.2007 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Shkronja “g” e nenit 3, shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 6:

1. Tabelat 2 dhe 4, ndryshohen si më poshtë:
- “2. Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transport ndërkombëtar udhëtarësh	Licencë	QKL, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009
Shërbimet në linjë të rregullt, të rregullta të specializuara	Autorizim	Ministria
Shërbimet vajtje-ardhje (lavjerrës)	Autorizim	Ministria
	Autorizim bilateral	ANALTIR
Shërbimet e rastit	Libër udhëtimi	ANALTIR
	Autorizim	Ministria
Agjenci transporti udhëtarësh	Licencë	Bashkia

4. Transporti ndërkombëtar i mallrave

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për të tretë dhe me qira	Licencë	QKL, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009
Transporti për llogari të vet	Certifikatë	DPSHTRR
Transporti i mallrave të rrezikshme	Certifikatë	DPSHTRR
Transporti ndërmjet dy e më shumë shteteve anëtare të ECMT/CEMT	Autorizim	ANALTIR

2. Paragrafi i parë, pas tabelës 4, ndryshohet si më poshtë:

“Licencat për transport udhëtarësh dhe mallrash brenda vendit lëshohen të shoqëruara me certifikatën e mjetit me të cilin kryhet transporti.

Në transportin ndërkombëtar, certifikatat e mjeteve të transportit të udhëtarëve ose mallrave lëshohen respektivisht nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

Neni 3

Në nenin 8 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Shkronjat “a” dhe “b” të pikës 4, zëvendësohen me pikën 4/1, si më poshtë:

“4/1 Në transportin rrugor për udhëtarë (shërbimet e rregullta, vajtje-ardhje dhe të rastit me autobus, si dhe shërbimin taksi) dhe mallra, transportuesi duhet të mbajë në bordin e mjetit certifikatën e kontrollit teknik vjetor Mod 020 ose 021 (respektivisht për transportin brenda vendit ose ndërkombëtar), si dhe në transportin rrugor të udhëtarëve edhe dokumentin mbi plotësimin e kushteve të komoditetit, në përputhje me aneksin 2 dhe 3 të udhëzimit nr.1649, datë 18.08.1999. Dokumentet e përmendura në këtë pikë janë subjekt për kontroll nga organet e kontrollit në rrugë.”.

Mungesa e këtyre dokumenteve përbën shkelje të rëndë të shkronjës “d” të nenit 8 të këtij udhëzimi dhe masa administrative arrin deri në heqjen e licencës në ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor.

Neni 4

Në nenin 11 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Me përjashtim të licencave të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, që lëshohen nga Qendra Kombëtare e Licencave e të parashikuara në kategoritë VII.1 dhe VII.2 të aneksit 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009, licencat/rinovimi i tyre për veprimtaritë e tjera të transportit rrugor lëshohen me afat pesëvjeçar.”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Certifikatat e mjeteve lëshohen me afat pesëvjeçar, por me kushtin që ato në asnjë rast nuk duhet ta kalojnë afatin e vlefshmërisë së licencës.

Në rast të ndërrimit, zëvendësimit, shitjes ose dhënies me qira të mjetit ose kur mjeti del jashtë përdorimit, ose kur subjekti pezullon/mbyll veprimtarinë e transportit është i detyruar të dorëzojë certifikatën origjinale të mjetit në zyrën e licencave, e cila e ka lëshuar atë.

5.1 Rastet e pajisjes ose jo me certifikatë të mjeteve të marra me qira.

a) Në rastin kur një mjet i marrë me qira nuk ndryshon fushën e operimit (për të tretë ose me qira ose për llogari të vet) për të cilën ai është pajisur me certifikatë, ai nuk pajiset me certifikatë të re, për pasojë, mjeti do të operojë me certifikatën e lëshuar për subjektin transportues që e ka dhënë atë me qira. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe për rastin kur merret me qira një mjet që operon në shërbimet e rastit të transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe përdoret për të njëjtin qëllim.

b) Në rastin kur një subjekt transportues për të tretë ose me qira merr me qira një mjet të pajisur me certifikatë për llogari të vet, ai duhet të pajisë mjetin me certifikatë për të tretë ose me qira.

c) Një subjekt transportues për llogari të vet mund të marrë me qira një mjet të pajisur me certifikatë për të tretë ose me qira pa qenë nevoja për ta pajisur atë me certifikatë të re.

d) Në rastin kur një mjet, i cili është certifikuar për të operuar brenda vendit në një fushë të caktuar (për të tretë ose me qira ose për llogari të vet), merret me qira për të kryer operacione në transportin ndërkombëtar qoftë edhe brenda asaj fushe për të cilën ai është pajisur me certifikatë, ai duhet të pajiset me një certifikatë të re për transport ndërkombëtar.

e) Në rastin kur një mjet, i cili është i pajisur me certifikatë për fushën (për të tretë ose me qira ose për llogari të vet) e transportit ndërkombëtar në një fushë të caktuar, merret me qira për të operuar brenda vendit në të njëjtën fushë, mjeti nuk ka nevojë që të pajiset me certifikatë të re.

f) Në dallim nga pikat e mësipërme çdo mjet i transportit të udhëtarëve, i marrë me qira, për operimin në shërbimet e rregullta të transportit të udhëtarëve, brenda ose jashtë vendit, do të pajiset me një certifikatë të re për operim në linjën/linjat ku do të operojë.

5.2 Në rastin kur një subjekt operon me një mjet të marrë me qira, në bordin e mjetit mbahet certifikata origjinale e lëshuar nga zyra e licencave dhe kopja e kontratës së qiramarrjes së mjetit, të cilat janë subjekt për kontroll nga organet e kontrollit në rrugë.”.

3. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 5

Pika 5 e nenit 15, ndryshon si më poshtë:

“5. Lejen e qarkullimit për çdo mjet.”.

Neni 6

Pika 3 e nenit 16, ndryshon si më poshtë:

“3. Lejen e qarkullimit për çdo mjet.”.

Neni 7

Paragrafi i dytë i pikës 1 të nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“Kriteret e përzgjedhjes së subjektit përcaktohen mbi bazën e kushteve të licencimit sipas nenit 8 të udhëzimit.”.

Neni 8

Për subjektet që dorëzojnë dokumentet për licencim ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, licencat do të lëshohen me afat pesëvjeçar.

Licencat dhe certifikatat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të kenë afatin e vlefshmërisë deri më datën për të cilën ato janë lëshuar.

Certifikatat që do të lëshohen pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të kenë afatin e vlefshmërisë të njëjtë me afatin e vlefshmërisë së licencës së lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Neni 9

Neni 38 shfuqizohet.

Neni 10

Udhëzimi i Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr.7, datë 15.10.2009, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi